



Drejtoria Komunale për Arsim

Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2008), nenit 47 pika c). të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr. 98 datë: 30.07.2012, nenit 2,3 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr.83 e datës 14.06.2013, dhe vendimit me numër 542 të datës 25.03.2026, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë **25.03.2026** shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për subvencionimin e transportit të nxënësve të arsimit të obliguar, brenda dhe jashtë Komunës së Fushë-Kosovës

1. Kjo thirrje ka për qëllim mbështetjen financiare për transportin e nxënësve për arsimin e obliguar , për :
 - 1.1 Nxënësit që ndjekin mësimin në institucione arsimore jashtë territorit të Komunës së Fushë-Kosovës, për shkak se shërbimet arsimore përkatëse nuk ofrohen brenda komunës.
 - 1.2 Nxënësit banojnë në vendbanime brenda territorit të Komunës së Fushë-Kosovës ku mungojnë institucionet arsimore;
2. Të drejtë aplikimi kanë nxënësit e arsimit të obliguar që janë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës pa kurrfarë dallimi etnik, gjinor, fetar dhe politik.
3. Relacionet e subvencionuara :
 - Lagja Nakaradë – Shfmu “Selman Riza” Fushë Kosovë
 - Lagja e Ronollëve – Shfmu “Laura Scotti” Graboc i Poshtëm
 - Fshati Harilaq – Shfmu “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe
 - Fshati Bardh i Vogël – Shfmu “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe
 - Fshati Harilaq i Vogël – Shfmu “Bajram Curri” Harilaq
 - Fshati Pomozotin – Shkolla Speciale “Përparimi” Prishtinë
- Përveç relacioneve të mësipërme, të drejtë aplikimi kanë edhe nxënësit që vijojnë mësimin jashtë komunës dhe që i plotësojnë kriteret sipas kësaj thirrje.

4. Kriteret për përfitim:

- Të jetë i regjistruar si nxënës në një institucion të arsimit të obliguar;
- Të dëshmojë vijimin e rregullt të mësimi;
- Të plotësojë një nga kushtet e përcaktuara në pikën 1 të kësaj thirrjeje.

5. Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Formulari për aplikim (i bashkëngjitur me thirrjen, ose merret në Zyrën për Shërbim me Qytetarë në Objektin e Komunës së Fushë-Kosovës);
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
- Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;
- Letërnjoftimi i prindit/kujdestarit ;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare (prindit/kujdestarit).

6. Mënyra e përzgjedhjes

Të gjithë aplikuesit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë thirrje do të përfitojnë subvencionim, në përputhje me buxhetin e ndarë nga Komuna e Fushë-Kosovës.

7. Afati dhe mënyra e aplikimit:

Data e njoftimit të thirrjes: **25.03.2026**

Afati për aplikim mbetet i hapur 15 ditë, nga data **26.03.2026** deri më **09.04.2026**.

Aplikimi bëhet fizikisht në Komunën e Fushë-Kosovës, përkatësisht në Zyrën për Shërbim me Qytetarë.

8. E drejta e ankesës

Aplikuesit kanë të drejtë ankese në Drejtorinë për Arsim brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e publikimit të listës së përfituesve.

Shënim: Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim



Adriatik Zeqiri